

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6810
E mërkurë, 25 janar 2023
çmimi 0.40

Mbi 41 milionë euro
planifikohen për ngritjen e
shërbimeve shëndetësore



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RRITJA E ÇMIMIT TË TATIMIT NË PRONË SHKAKTON PAKËNAQËSI TE QYTETARËT,
KOMUNAT IA HEDHIN FAJIN QEVERISË KURTI

RRITET ÇMIMI I TATIMIT NË PRONË

- Ministria e Financave: Nga ky vit të gjitha tokat rezidenciale, komerciale,
industriale dhe pyjore tatimohen me 100 për qind të vlerës së vlerësuar



Krahas rritjes enorme të çmimeve të produkteve elementare, në Kosovë është rritur edhe tatimi i çmimit në pronë. Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka bërë me dije se rritja e këtij çmimi nuk është bërë nga komunat. Ky asociacion ka treguar se

komunat nuk e kanë ngritur normën tatimore, por është bërë rivlerësimi i pronave nga Ministria e Financave dhe me këtë rast është rritur vlera e pronave bazuar në çmimet e tregut. Ndërsa kjo ministri ka njoftuar qytetarët se tatimi në pronë mbledhet nga komunat

dhe përbën njërin prej burimeve kryesore të të hyrave vetjake për komunat. Ministria e drejtuar nga Hekuran Murati u ka bërë thirrje qytetarëve që për çdo ankesë ndaj vlerës së vlerësuar për pronën t'u drejtohen komunave përkatëse

23 VJET NGA
THEMELIMI I
GAZETËS
"EPOKA E RE"



BIDENI NOMINON DAVID
J. KOSTELANCIKUN PËR
AMBASADOR NË SHQIPËRI

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KUPA NË RAHOVEC F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Koreja Veriore paralajmëron banorët për “mot ekstrem”



SAMIYON, 24 JANAR - Autoritetet verikoreane kanë paralajmëruar për mot ekstrem teksa i ftohti po përfshin Gashishullin Korean.

Temperaturat pritet të ulen nën -30 gradë celsius në rajonet veriore, njëherësh zonat më të varfra të shtetit, ka transmetuar radioja shtetërore.

Zonat bregdetare pritet të përballen me erëra të fuqishme.

Edhe Koreja Jugore, gjithashtu, ka lëshuar paralajmërim të ngjashëm, derisa në veri të Kinës temperaturat kanë rënë

në nivel rekord.

Japonia pritet të përballlet me situatë të ngjashme në ditët në vijim.

Radio Azia e Lirë ka raportuar në dhjetor të vitit të kaluar se “një numër i madh i njerëzve” janë zhdukur në kohën e motit ekstrem - shumica prej tyre besohet të kenë vdekur nga i ftohti, apo vështirësitë në sigurim të ushqimit në kushte të tilla.

Kriza ushqimore në Korenë Veriore besohet se është më e rënda prej viteve 1990.

Më 2019 Kombet e Bashkuara

kanë thënë se deri në 10 milionë verikoreane “kanë nevojë urgjente për ushqim” pas raportimeve se shumë njerëz janë duke mbijetuar me vetëm 300 gramë ushqim në ditë.

Më 2020 Koreja Veriore është goditur nga pesë tajfunë të fuqishëm të cilët kanë shkaktuar dëme të mëdha në ndërtesa, rrugë, fabrika dhe sistemet ujore.

Shkencëtarët besojnë se moti ekstrem është duke u bërë më i shpeshtë për shkak të ndryshimeve klimatike.

Polonia kërkon zyrtarisht leje nga Gjermania për dërgimin e tankeve në Ukrainë

VARSHAVË, 24 JANAR - Polonia ka kërkuar zyrtarisht leje nga Gjermania për t'i transferuar tanket e saj Leopard 2 në Ukrainë, ka njoftuar më 24 janar ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak. Berlini ka marrë kërkesën e Varshavës, tha Blaszczak në një postim në “Twitter”.

“Gjermania tashmë ka marrë kërkesën tonë që ta lejojë transferimin e tankeve Leopard 2 në Ukrainë. I bëj thirrje edhe palës gjermane që t'i bashkohet koalicionit të vendeve që mbështetin Ukrainën me tanke Leopard 2. Kjo është kauza jonë e

përbashkët, sepse ka të bëjë me sigurinë e të gjithë Evropës”, ka shkruar Blaszczak.

Ukraina ka kërkuar që tanket perëndimore ta ndihmojnë atë të zbrapset kundër pushtimit rus.

Më herët gjatë ditës, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, është shprehur i bindur se Aleanca do të gjejë një zgjidhje të shpejtë për dërgimin e tankeve luftarake në Ukrainë. “Në këtë moment kyç të luftës ne duhet të ofrojmë sisteme më të rënda dhe më të avancuara në Ukrainë dhe ne duhet ta

bëjmë një gjë të tillë më shpejt”, u tha Stoltenbergu gazetarëve, duke qëndruar përkrah ministrit gjerman të Mbrojtjes, Boris Pistorius, më 24 janar.

Pistorius tha se nuk ka përçarje midis aleatëve për dërgimin e tankeve të rënda luftarake në Ukrainë, por tha se kancelari Olaf Scholz po përpiqej të krijonte konsensus për këtë çështje.

Pistorius shtoi se NATO nuk duhet të bëhet palë në luftën në Ukrainë.

Ai tha se Gjermania nuk po pengon vendet e tjera t'i trajtojnë trupat ukrainase



për t'i përdorur tanket Leopard.

Presioni është rritur mbi qeverinë e kancelarit gjerman Olaf Scholz për t'i dërguar tanket Leopard në Ukrainë

dhe për t'i lejuar vendet e tjera të bëjnë të njëjtën gjë. Sipas rregullave të prokurimit ushtarak, Gjermania duhet të autorizojë çdo rieksporim të këtyre tankeve.

OBSH-ja kërkon “veprim të menjëhershëm” pas vdekjeve nga shurupi i kollës



GJENEVË, 24 JANAR - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka bërë thirrje për “veprim të menjëhershëm dhe të koordinuar” për t'i mbrojtur fëmijët nga ilaçet e kontaminuara pas një morie vdekjesh të fëmijëve që ndodhën vitin e kaluar, të lidhura me shurupet e kollës.

Në vitin 2022 më shumë se 300

fëmijë, kryesisht të moshës nën 5 vjeç, vdiqën nga dëmtimi akut i veshkave në Gambi, Indonezi dhe Uzbekistan. Këto vdekje dyshohet se u shkaktuan nga ilaçe të kontaminuara, tha OBSH-ja në një deklaratë më 24 janar.

Shurupet e kollës, pa recetë, kishin nivele të larta të dietilenit glikolit dhe etilenit glikolit. “Këta

ndotës janë kimikate toksike që përdoren si tretës industriale dhe mund të jenë fatale edhe nëse merren në sasi të vogla. Ato nuk duhet të gjenden kurrë në ilaçe”, ka njoftuar OBSH-ja.

Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se shtatë vende kishin raportuar se kishin gjetur shurupe të kontaminuara në katër muajt e fundit dhe u bëri

thirrje 194 shteteve anëtare në këtë organizatë që të veprojnë menjëherë për të parandaluar më shumë vdekje. “Meqenëse këto nuk janë incidente të izoluara, OBSH-ja u bënë thirrje palëve të përfshira në zinxhirin e furnizimit mjekësor, të ndërmarin veprime të menjëhershme dhe të koordinuara”, ka njoftuar OBSH-ja.

Estonia dhe Letonia kërkojnë largimin e ambasadorëve të Rusisë

TALINI, 24 JANAR - Shtetet anëtare të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, Estonia dhe Letonia, kanë kërkuar largimin e ambasadorëve rusë nga shtetet përkatëse, pas njoftimit të Rusisë për ulje të marrëdhënieve diplomatike me Estoninë, duke e akuzuar atë për “rusofobi totale”. Ministria e Jashtme ruse deklaroi

se ambasadorit të Estonisë do t'i kërkohet të largohet muajin e ardhshëm dhe se të dyja vendet do të përfaqësohen nga të ngarkuarit me punë të përkohshme në vend të ambasadorëve.

Estonia u përgjigj në mënyrë të ngjashme, me ministrin e Jashtëm, Urmas Reinsalu, që

njoftoi se të dërguarit rus do t'i kërkohet të largohet deri më 7 shkurt.

Mosmarrëveshja diplomatike ndodhi pasi ministrat e jashtëm të BE-së u takuan në Bruksel për të diskutuar, mes të tjerash, për agresionin e Rusisë kundër Ukrainës.

Tri vendet baltike kanë qenë të

zëshme për të kërkuar sanksione më të ashpra për Rusinë si dhe ndihmë më të mirë për Ukrainën.

Estonia, Letonia dhe fqinja e tyre baltike, Lituania, kanë qenë pjesë e shteteve aleate në NATO që kanë insistuar fuqishëm që Gjermania të sigurojë tanke luftarake Leopard për ta ndihmuar Ukrainën që t'i rezistojë pushtimit rus.



Kamberi i shkruan letër Escobarit: Luginë të përfshihet në dialog

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 JANAR - Përfaqësuesi i vetëm shqiptar në Parlamentin e Serbisë, deputeti Shaip Kamberi, i ka shkruar një letër të dërguarit special të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Kamberi i është drejtuar Escobarit me kërkesën për përfshirjen e Luginës së Preshevës në procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, duke qenë se, sipas tij, në negociata po rezultojnë të ketë një dinamikë të re. "Në fazën kur ndërmjetësuesit ndërkombëtarë duke se dialogut të Kosovës me Serbinë po i japin një dinamikë të re, në pritje që edhe Luginë e Preshevës të përfshihet, në dialogun të cilin e quan si mundësi e fundit për ta zgjidhur çështjen e shqiptarëve, sot, përmes kësaj letrë, iu drejtova të dërguarit të posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimorë, z. Gabriell Eskobar. Një letër me përmbajtje të njëjtë do t'ia përcjell edhe Josep Borellit, përfaqësues i lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian", ka bërë me dije Kamberi.

Ai ka theksuar se gjendja e komunitetit shqiptar në Preshevë mbetet e vështirë përkundër zotimeve të Qeverisë së Serbisë për të punuar drejt një të ardhmeje të begatë dhe garancive të ofruara për komunitetin shqiptar nga bashkësia ndërkombëtare pas konfliktit të armatosur më 2001. "Kur u nënshkrua marrëveshja e paqes, shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit u bënë të besonin se dialogu dhe reformat e vërteta politike do ta përmirësonin ndjeshëm gjendjen e përgjithshme të shqiptarëve dhe do të angazhoheshin në negociata me autoritetet e Beogradit në mirëbesim. Vonesat e përsëritura për përbushjen e këtyre zotimeve çuan në dy



marrëveshje shtesë për afirmimin e të drejtave të shqiptarëve (2009 dhe 2013), të cilat, për fat të keq, mbeten kryesisht të pazbatuara nga autoritetet e Beogradit. Ndërsa e shkruaj këtë letër 22 vjet pas konfliktit, komuniteti shqiptar në Luginën e Preshevës mbetet minoriteti më i diskriminuar në Republikën e Serbisë. Nuk është marrë asnjë masë për t'i dhënë fund diskriminimit ekonomik

ndaj shqiptarëve, për ta adresuar përfaqësimin shumë të ulët të shqiptarëve në institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet e kontrolluara nga qeveria dhe për ta zvogëluar praninë e forcave ushtarake në rajon", ka deklaruar Kamberi.

Ai ka thënë se që nga viti 2008 qëndrimi armiqësor i Serbisë ndaj pavarësisë së Kosovës ndikoi negativisht te shqiptarët në Preshevë pasi, sipas tij, Serbia

refuzon t'i njohë diplomat universitare nga universitetet e Kosovës duke shkualifikuar kështu 15 breza shqiptarësh me diploma të Kosovës nga punësimi në institucionet shtetërore. "Shqiptarëve në Luginën e Preshevës aktualisht u mohohet e drejta e përdorimit të simboleve dhe flamurit kombëtar, element kyç i identitetit kombëtar shqiptar. Militarizimi përdoret

vazhdimisht si një strategji frikësuese ndaj komunitetit vendas shqiptar", është shprehur ai.

Deputeti Kamberi ka pohuar se efektet e kombinuara të shtypjes së identitetit kombëtar, diskriminimit, keqtrajtimit dhe frikësimit po i detyrojnë të rinjtë të largohen nga Luginë e Preshevës në kërkim të mundësive më të mira në vendet anëtare të BE-së. "Meqenëse diskriminimi politik dhe institucional i shqiptarëve të Luginës së Preshevës është shpesh pasojë e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ne besojmë se përfshirja e komunitetit shqiptar në Preshevë në dialog do t'u ndihmojë ndërmjetësuesve të BE-së dhe ShBA-së që të punojnë në mënyrë simetrike dhe të balancuar, aranzhimet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave për komunitetin shqiptar në Serbi dhe komunitetin serb në Kosovë në përputhje me vlerat evropiane dhe aktet ndërkombëtare. Në dritën e përpjekjeve të ripërtëritura të ndërmjetësuesve të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe angazhimit të shtuar të ShBA-së, në cilësinë time si përfaqësues i zgjedhur i shqiptarëve të Luginës së Preshevës (deputet i Kuvendit të Serbisë), ju bëj thirrje që në takimet e radhës të dialogut të udhëhequr nga BE-ja ta përfshini situatën e shqiptarëve të Luginës së Preshevës si një element thelbësor për arritjen e paqes afatgjatë dhe të qëndrueshme ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve", ka theksuar Kamberi, duke ritheksuar se përfaqësuesit e zgjedhur të shqiptarëve të Luginës së Preshevës mbeten plotësisht të përkushtuar për t'i mbështetur përpjekjet për ta arritur normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë bazuar në respektin dhe reciprocitetin reciprok.

Bideni nominon David J. Kostelancik për ambasador në Shqipëri

TIRANË, 24 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka nominuar emra të rinj për të shërbyer si udhëheqës kryesorë në administratën e tij, përfshirë disa ambasadorë, në mesin e të cilëve është edhe i nominuari për ambasador të ardhshëm në Shqipëri.

Biden nominoi diplomatit David J. Kostelancik për postin e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Pas nominimit nga kreu i Shtëpisë së Bardhë, propozimi i kalon Senatit për miratim, më pas pritjet që Kostelancik ta marrë zyrtarisht detyrën duke

zëvendësuar ambasadorin Yuri Kim.

David J. Kostelancik, diplomat karriere, aktualisht shërben si këshilltar për politikën e jashtme i gjeneralit Mark Milley. Ai ka shërbyer më herët si zëvendësues i Misionit të ShBA-së në Hungari, dhe për dy vjet i ngarkuar me punë i përkohshëm në Ambasadën e ShBA-së në Budapest.

Diplomati ka qenë i përfshirë në Misionin e ShBA-së në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe në Misionin e ShBA-së në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior

(NATO).

Ai ka ushtruar disa detyra të rëndësishme si: drejtor i Zyrës për Çështjet e Evropës Jugore e Qendrore dhe drejtor i Zyrës për Çështjet Ruse në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike, si dhe drejtor i Zyrës së Evropës dhe Azisë në Byronë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjit. Kostelancik ka shërbyer dy herë në Ambasadën e ShBA-së në Rusi.

Ambasadorja aktuale amerikane në Tiranë, Yuri Kim, e nisi misionin e saj në Shqipëri më 22 janar 2020.





RRITJA E ÇMIMIT TË TATIMIT NË PRONË SHKAKTON PAKËNAQËSI TE QYTETARËT, NDËRKAQ KOMUNAT IA HEDHIN FAJIN QEVERISË KURTI

RRITET ÇMIMI I TATIMIT NË PRONË

- Ministria e Financave: Nga ky vit të gjitha tokat rezidenciale, komerciale, industriale dhe pyjore tatimohen me 100 për qind të vlerës së vlerësuar

Krahas rritjes enorme të çmimeve të produkteve elementare, në Kosovë është rritur edhe tatimi i çmimit në pronë. Asociacioni i Komunave i Kosovës (AKK) ka bërë me dije se rritja e këtij çmimi nuk është bërë nga komunat. Ky asociacion ka treguar se komunat nuk e kanë ngritur normën tatimore, por është bërë rivlerësimi i pronave nga Ministria e Financave dhe me këtë rast është rritur vlera e pronave bazuar në çmimet e tregut. Ndërsa kjo ministri ka njoftuar qytetarët se tatimi në pronë mbledhet nga komunat dhe përbën njërin nga burimet kryesore të të hyrave vetjake për komunat. Ministria e drejtuar nga Hekuran Murati u ka bërë thirrje qytetarëve që për çdo ankesë ndaj vlerës së vlerësuar për pronën t'u drejtohen komunave përkatëse. Në anën tjetër, LDK-ja ka kërkuar nga qeveria Kurti që urgjentisht ta pezullojë vendimin për dyfishim të çmimit të tatimit në pronë

Transfereve, e cila përcakton zonat e vlerave, nivelet e vlerave dhe vlerën e vlerësuar të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunave. "E kuptojmë plotësisht shqetësimin tuaj, por me qëllim të informimit të drejtë të qytetarëve rreth këtij procesi, ju informojmë se: Bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, 'autoriteti kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit është Ministria e Financave e cila përcakton zonat e vlerave, nivelet e vlerave dhe vlerën e vlerësuar të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunave. Vlerësimi i pronave të paluajtshme kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Ligj dhe në aktin nënligjor që nxjerr Ministria e Financave për kategoritë e vlerave, metodat dhe modelet e vlerësimit'. Komuna e Prishtinës nuk e ka bërë përcaktimin e shumave në faturat e qytetarëve për vitin tatimor 2023", ka njoftuar Komuna e Prishtinës. Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kërkuar nga

qeveria Kurti që urgjentisht ta pezullojë vendimin për dyfishim të çmimit të tatimit në pronë. "LDK-ja kërkon nga Qeveria e Kosovës që urgjentisht t'i rishikojë të gjitha mundësitë ligjore për ta pezulluar rivlerësimin e tatimit në pronë për vitin 2023, duke mos lejuar rritjen e ngarkesës tatimore në pronë për qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, Ministria e Financave sa më shpejt ta dërgojë ligjin e ri për tatimin në pronë në Kuvend në mënyrë që t'u mundësohet komunave ulja e pragut të normës tatimore", është thënë në reagimin e LDK-së. Kurse koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin e Qeverisjes së Mirë në PDK, Arben Mustafa, ka thënë se një politikë e tillë e qeverisë Kurti në këtë kohë krize është vështirë e kuptueshme. "Në kohën kur qytetarët e Kosovës po ballafaqohen me një goditje shumë të rëndë të standardit të jetesës si rrjedhojë e rritjes së çmimeve, Qeveria e Kosovës paska vendosur ta dyfishojë tatimin në pronë për shumë qytetarë, duke ua rënduar edhe më tej gjendjen veçse të rënduar

ekonomike. Kjo politikë e qeverisë për t'i ngarkuar qytetarët me tatime më të larta në këtë kohë krize është vështirë e kuptueshme dhe flet më së miri për kapacitetet e dobëta qeverisë dhe shpërfilljen që kjo qeveri po ua bën vështirësive me të cilat po ballafaqohen qytetarët. Me politika si kjo, Qeveria e Kosovës po dëshmon se është duke jetuar e shkëputur nga realiteti i zymtë ekonomik që po mbretëron në Kosovë!", ka shkruar Mustafa në "Facebook".

**Ministria e Financave:
Tokat rezidenciale,
komerciale, industriale
dhe pyjore tatimohen
me 100 për qind të
vlerës së vlerësuar**

Pas komunës së Prishtinës, ka reaguar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), e cila drejtohet nga ministri Hekuran Murati. Kjo ministri ka njoftuar qytetarët se tatimi në pronë mbledhet nga komunat dhe përbën njërin nga burimet kryesore të të hyrave vetjake të tyre. "MFPT-ja, bazuar në Ligjin

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 24 JANAR - Qytetarët e Kosovës, veçanërisht ata të Prishtinës, janë ankuar për rritjen e çmimit të tatimit në pronë. Sipas ankesave, të cilat kanë qarkulluar në rrjetet sociale të martën, në vitin 2022 për tatimin në pronë në Prishtinë një qytetar ka paguar 119 euro, ndërsa në vitin 2023 do të pagujë mbi 523 euro.

Ndaj këtyre shqetësimeve të cilat janë pasqyruar edhe në medie kanë reaguar komunat dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Fillimisht ka reaguar komuna e Prishtinës, e cila drejtohet nga Përparim Rama.

Kjo komunë ka bërë me dije se autoriteti kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit të pronave është Ministria e Financave, Punës dhe

për Tatim në Pronë, obligohet që në baza të rregullta të bëjë vlerësimin e pronave të paluajtshme, ndërsa shkallën e tatimit e përcaktojnë vetë komunat. Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të MFPT-së përgjatë vitit 2022 ka kryer vlerësimin e përgjithshëm të tokave dhe objekteve rezidenciale si dhe ka përpiluar raporte të vlerësimit për prona rezidenciale me datë 31.10.2022, për të cilat janë njoftuar të gjitha komunat. Përgjatë vlerësimit të pronave rezidenciale, Departamenti i Tatimit në Pronë ka bashkëpunuar ngushtë me komunat për ta përcaktuar çmimin për m2 për objekte dhe toka, është thënë në reagimin e MFPT-së.

MFPT-ja ka bërë me dije se nga ky vit të gjitha tokat rezidenciale, komerciale, industriale dhe pyjore do të tatimohen me 100 për qind të vlerës së vlerësuar. “Vlen të theksohet se në vitin tatimor 2023 nuk zbatohet zbritja e përgjithshme për tokat, pasi që tanimë kemi hyrë në vitin e 5-të të tatimit të tokave. Nga ky vit, të gjitha tokat rezidenciale, komerciale, industriale dhe pyjore tatimohen me 100 për qind të vlerës së vlerësuar, për dallim nga viti i kaluar ku është zbatuar zbritja e përgjithshme prej 20-përqindësh, ku tokat janë tatimuar me 80 për qind të vlerës së vlerësuar”, është thënë në këtë

reagim. Më tutje MFPT-ja u ka bërë thirrje qytetarëve se për çdo ankesë ndaj vlerës së vlerësuar për pronën t’u drejtohen komunave përkatëse, e cila do të shqyrtohet nga Departamenti i Tatimit në Pronë pranë kësaj ministrie. “Për çdo ankesë ndaj vlerës së vlerësuar për pronën tuaj udhëzoheni të drejtoheni pranë komunës tuaj për të paraqitur ankesë ndaj certifikatës së vlerës së vlerësuar, e cila pastaj shqyrtohet nga Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve”, është thënë në reagimin e MFPT-së.

AKK-ja: Komunat nuk e kanë rritur faturën e tatimit në pronë

Përkritazi me rritjen e çmimit të tatimit në pronë është deklaruar edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK). Ky asociacion ka bërë me dije se komunat nuk e kanë rritur faturën e tatimit në pronë. “Pas reagimeve të qytetarëve për rritjen e çmimit të faturës për tatimin në pronë, duhet të sqarojmë se kjo rritje nuk vjen nga komunat. Fatura e tatimit në pronë përmban dy elemente mbi bazën e të cilave përcaktohet shuma e kësaj pagese: 1. Vlera e pronës për metër katror (m/2) e cila

Rritja e çmimit të tatimit në pronë përplas Muratin dhe Bajramin në komision

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, pas përplasjes me deputeten e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka lëshuar mbledhjen të martën pa nisur raportimin për të cilin ishte ftuar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ministri Murati e ka lëshuar mbledhjen duke thënë se tatimi në pronë nuk është tema që është ftuar për të raportuar. “Nëse ka rend të ditës mund ta kaloni. Nëse keni thirr konferencë për medie është dashur të na tregoni. Çështja e tatimit në pronë është në ligjin e 2018-s. Unë si ministër nuk kam marrë asnjë vendim për ta rritur çmimin. Vlerësimi, mesa u njoftova sot, është se ky

vlerësim i është dorëzuar komunave në muajin tetor, në përjashtim të tri komunave, mirëpo tani që po vendoset nga disa komuna, si e Prishtinës dhe nga ju, është tepër e ulët”, ka thënë Murati. Ndërsa kryesuesja e komisionit, Hykmete Bajrami nga LDK-ja, ka thënë se e ka pyetur ministrin për çështjen e tatimit në pronë pasi, sipas saj, “është bërë temë e nxehtë”. “Sipas çmimeve të tregut, vlera e patundshmërive është rritur qind për qind, Komuna e Prishtinës nuk i ka lëvizë tarifën, por kur është rritë baza tatimore, normalisht që është dyfishuar, ajo çka kërkohet është që Ministria e Financave, ta

pezullojë rivlerësimin. Komunat në momentin e tanishëm nuk mund të bëjnë asgjë. Komuna e Pejës e ka ulur tatimin, por prapë faturat shkojnë të rritura si rezultat i rritjes së çmimit bazuar në rivlerësim”, ka thënë Bajrami. Pas Muratit janë larguar edhe deputetët e Vetëvendosjes, përveç Eman Rrahmanit që fillimisht qëndroi brenda, por që e ka kritikuar Bajramin për qasje të gabuar. Por më pas është larguar nga mbledhja edhe Rrahmani, pasi deputetja Bajrami i ka thënë se ai “vjen nga një parti që fjala e lirë nuk respektohet”. Derisa Rrahmani i është drejtuar Bajramit duke i thënë se deri në vitin 2013 ka qenë në LDK.

përcaktohet nga Ministria e Financave dhe Transfereve (Departamenti i Tatimit në Pronë) dhe 2. Norma tatimore e cila përcaktohet nga komunat. Bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Tatimin në Pronë e Paluajtshëm, ‘autoriteti kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit është Ministria e Financave e cila

përcakton zonat e vlerave, nivelet e vlerave dhe vlerën e vlerësuar të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunave. Vlerësimi i pronave të paluajtshme kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Ligj dhe në aktin nënligjor që nxjerr Ministria e Financave për kategoritë e vlerave, metodat dhe

modelet e vlerësimit’. Së këndejmi, vlen të sqarohet se komunat nuk e kanë ngritur normën tatimore, por është bërë rivlerësimi i pronave nga Departamenti përkatës i Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe me këtë rast është rritur vlera e pronave bazuar edhe në çmimet e tregut”, është thënë në reagimin e AKK-së.

23 vjet nga themelimi i gazetës “Epoka e re”



PRISHTINË, 24 JANAR - Gazeta e përditshme “Epoka e re” është themeluar më 15 dhjetor 1999, por numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000. Sot (e mërkurë) “Epoka e re” ka mbushur 23 vjet që nga numri i parë. Në këto vite gazeta ka pasur edhe sfida, disa të rënda e disa të lehta, por deri më sot i ka kaluar të gjitha me sukses. “Epoka e re” botohet online <https://www.epokaere.com/> dhe në formatin PDF. Pas fillimit të pandemisë Covid-19 edhe në Kosovë, pas vendosjes së masave kufizuese nga institucionet e vendit, për parandalimin e përhapjes së

kësaj pandemie dhe futjen e vendit në izolim, u ndal edhe botimi i medieve të shtypura. Sot Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në botë pa gazetë të shtypur ditore. Në formatin PDF sot është botuar numri i 6 811 i “Epokës së re”. Botues i gazetës “Epoka e re” është Muhamet Mavraj, personalitet i njohur i demonstratave studentore të vitit 1997. “Epoka e re” shquhet për kuadrin e saj kritik gazetaresk, i cili synon arritjen e një informacioni të ri në mjedisin shqiptar dhe formësimin e audiencës kritike.

EPOKA E RE SUPER OFERTË 79.99 €

50 x Gota
50 x Kapsula
50 x Sheqera
50 x Lugë

GRATIS

E martë, 24 janar 2023

Ballina Lajme Ekonomi Intervista Opinione Komuna Fejtone Botë Kulturë Sport Diaspora Spektër Shpallje Tech

SIJUNA SHOPPE

Kulla e shqipes 2.0

GAZETA

24 JANAR, 2023 01:26 23 JANAR, 2023 06:46 21 JANAR, 2023 01:33 20 JANAR, 2023 01:08

Rikycet largpërçuesi Rugova, konsumatorëve u kthehet furnizimi me energji elektrike

PEJË, 24 JANAR - Prishja në largpërçuesin Rugova që la pa energji konsumatorët në Rugovë është sanuar tashmë, ka njoftuar KEDS-i "falë një angazhimi të pashoq të ekipeve tona që ishin vazhdimisht bjeshkëve

të Rugovës, duke e sfiduar borën dhe terrenin e vështirë, vetëm që konsumatorëve t'u rikthehet energjia elektrike. Tashmë shumica e rugovasve janë duke u furnizuar. Ka mbetur vetëm një pjesë e vogël e

konsumatorëve, porse ekipet e KEDS-it akoma janë në terren në Rugovë dhe gjatë ditës së sotme pritet që edhe atyre t'u rikthehet furnizimi i rregullt me energji elektrike", ka njoftuar KEDS-i.



Vritet një 48-vjeçar në Kaçanik

KAÇANIK, 24 JANAR - Policia e Kosovës ka njoftuar se më 23.01.2023 rreth orës 23:50 policia e Stacionit në Kaçanik ka pranuar një informacion se në rrugën magjistrale Ferizaj - Kaçanik, në Kaçanik të Vjetër, një automjet i udhëtarëve ishte jashtë rruges.

Policia e Stacionit në Kaçanik menjëherë i ka marrë masat e nevojshme, ka dalë në vendin e ngjarjes dhe policët kanë vërejtur se një person në ulësen e parë të shoferit dyshohej se ishte pa shenja jete. "Janë njoftuar ekipet mjekësore të cilat kanë konstatuar se personi është pa shenja jete. Nga hetimet e para, ekzaminimit të vendit të ngjarjes, dyshohet se personi/persona të panjohur në Kaçanik të Vjetër nga afërsia

kanë shtënë me breshëri plumbash mbi automjetin dhe shoferin e më pas janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur. Jo larg vendit të ngjarjes në fshatin Soponicë të Kaçanikut është gjetur edhe një automjet tjetër i udhëtarëve i përfshirë nga flaka, ku ekziston dyshimi se personat e dyshuar, pasi e kanë kryer vrasjen në Kaçanik të Vjetër, i kanë vënë flakën automjetit dhe janë larguar", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipas njoftimit, me vendim të prokurorit kujdestar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj trupi i pajetë i viktimës N. C. (M/K), i moshës 48-vjeçare, është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë për obduksion.



Regjistrimi i popullsisë, përfaqësuesit e ASK-së takojnë kryetarin e Gjilanit dhe atë të Kamenicës



GJILAN, 24 JANAR - Përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës kanë vazhduar takimet me kryetarët e komunave për të biseduar mbi aktivitetet e regjistrimit të popullsisë më 2023. Ata kanë takuar kryetarin e Gjilanit, Alban Hyseni dhe atë të Kamenicës, Kadri Rahimaj. "Në të dy komunat kemi pranuar mbështetjen e plotë

dhe gatishmërinë për aktivitete në bazë të përgjegjësisë që kanë komunat në kuadër të komisioneve komunale të regjistrimit", kanë theksuar zyrtarët e ASK-së. Regjistrimi i popullsisë me 1 shtator - 16 tetor 2023 do të mbledhë të dhëna mbi indikatorët demografikë e socio-ekonomikë të cilët do të

na ndihmojnë t'i kuptojmë qartë nevojat e qytetarëve tanë dhe për të hartuar politika të drejta bazuar në kërkesa reale për përmirësim të jetës në sektorë të ndryshëm në vend. Agjencia e Statistikave e Kosovës do të jetë pranë komunave përmes qasjes dhe ofrimit të të dhënave statistikore koherente dhe të besueshme.

Dita Ndërkombëtare e Arsimit, Totaj: Ndër prioritetet kryesore kemi zhvillimin e arsimit



PRIZREN, 24 JANAR - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Arsimit, kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka përshëndetur mësimmësuesit dhe nxënësit për kontributin në ruajtjen e frymës akademike në

institucionet tona arsimore që, sipas tij, vjen si pasojë e qëndresës së pashoqe të arsimtarëve në vitet më të vështira të kombit që nuk lejuan vakum në procesin drejt dijes. "Komuna e

Prizrenit, ndër prioritetet kryesore, ka zhvillimin e arsimit dhe mbështetjen e çdo aktiviteti të nxënësve që çon përpara punën tonë të përbashkët drejt zhvillimit intelektual", ka theksuar Totaj.

Projektligji për Sigurinë Kibernetike procedohet për shqyrtim të dytë në seancën plenare

PRISHTINË, 24 JANAR - Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i kryesuar nga Bekë Berisha, kryetar, në mbledhjen e mbajtur të martën, shqyrtoi

raportin me rekomandime për Projektligjin për Sigurinë Kibernetike. Me vota unanime projektligji u procedua për seancë plenare për shqyrtim të

dytë. Komisioni, gjithashtu, shqyrtoi raportin me rekomandime për Projektligjin për Tubime Publike, i cili u procedua për

seancë plenare për shqyrtim të dytë. Në këtë mbledhje komisioni u pajtua që të realizojë disa vizita në terren pas përmbytjeve në disa rajone të Kosovës.



Mbi 41 milionë euro planifikohen për ngritjen e shërbimeve shëndetësore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga zëvendësministri Dafina Gexha, zëvendësministri Arsim Berisha dhe sekretari i përgjithshëm Naim Bardiqi, mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga grupi punues kyç për hartimin e Planit Strategjik për zbatimin e fizibilitetit dhe raportit shtesë për studimin "Ngritja e infrastrukturës dhe pajisjeve për kujdesin dytësor dhe tretësor". Gjatë këtij takimi ministri Vitia theksoi urgjencën e përmirësimit të shërbimeve shëndetësore si një prej prioritetëve kryesorë të qeverisë Kurti. Në këtë takim ministri Vitia ka theksuar se është hera e parë që kemi një plan të tillë strategjik për ngritjen e infrastrukturës dhe pajisjeve për kujdesin dytësor dhe tretësor. "E dimë që janë probleme sistematike, por nga stafi shëndetësor nuk mund ta kërkojmë maksimumin kur mungojnë parakushtet për të ofruar shërbime sa më cilësore

për qytetarët tanë që është edhe objektivi kryesor. Pasi shëndetësia është një prej prioritetëve të Qeverisë së Kosovës, gjë që dëshmohet edhe me rritjen e buxhetit që është më i larti deri më tani, si dhe me donatorët tanë të cilët kanë shprehur gatishmërinë, ky plan, sado ambicioz, do të jetë i realizueshëm", ka pohuar ministri Vitia.

Ai u shpreh se të gjithë duhet ta bëjmë maksimumin që ta ngrehim nivelin e shërbimeve shëndetësore dhe se të gjithë jemi para një përgjegjësie të jashtëzakonshme për mirëqenien dhe shëndetin e qytetarëve tanë. Sipas tij, kjo arrihet vetëm duke i diskutuar problemet, nevojat dhe kërkesat e jo duke i fshehur ato.

Grupi punues në planin e veprimit ka përcaktuar propozimet e dala nga studimi me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në një periudhë afatshkurtër.

Disa nga objektivat e grupit punues janë riorganizimi i shërbimeve shëndetësore sekondare dhe terciare në spitalet



e përgjithshme, adaptimi i numrit të shtretërve spitalorë nevojave të shërbimeve spitalore për pacientë, modalitetet e financimit dhe sigurimi i pajisjeve të domosdoshme mjekësore, pagesa sipas performances të profesionistëve shëndetësorë, janë disa nga objektivat e përfshira në planin strategjik të përpiluar nga përfaqësuesit e

MSH, ShSKUK, spitaleve të përgjithshme dhe përfaqësues të tjerë në sektorin e shëndetësisë. Ky aktivitet bazohet në studimin e fizibilitetit në kuadër të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF) që është realizuar në vitin 2022, por meqenëse gjatë periudhës 2018-2022 janë siguruar pajisje, Ministria e Shëndetësisë në vitin

2018 ka bërë rivlerësimin e studimit të parë që synon sigurimin e pajisjeve për nivelin dytësor dhe tretësor.

Ky studim është miratuar nga Mekanizmat e Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor dhe pritet hartimi i planit të veprimit. Propozimi për koston e projektit është 41.067.355 euro.

Mehaj pret në takim lamtumirës komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas

PRISHTINË, 24 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, kanë pritur me nderime të larta ushtarake, në vizitën e tij lamtumirëse, komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Benjamin J. Corell. Me këtë rast, ministri Mehaj e dekoroi gjeneralin Corell me Medalje për Shërbim të Shquar, e cila iu dha për shërbimin e tij shembullor dhe kontributin e dhënë në forcimin e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Gardës Kombëtare të Iowas. Ndërsa për angazhim të jashtëzakonshëm dhe vetëmohues, për kohën sa ka shërbyer komandant i Gardës Kombëtare të Iowas, në



mbështetjen e FSK-së në ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale dhe

operacionale, veçanërisht në ndërveprimin mes Ushtrisë së ShBA-së dhe FSK-së, edhe për

operacionet në misionet paqeruajtëse, gjeneral Jashari i dha gjeneralit Corell Medaljen

për Shërbim Vetëmohues.

Në këtë takim ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari falënderuan gjeneralin Corell për kontributin e tij të dhënë në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, duke theksuar se progresi dhe të arriturat e deritashme janë edhe rezultat i përpjekjeve dhe punës së tij me përkushtim të lartë. Nga ana e tij, gjeneral Corell falënderoi për nderimet, respektin dhe pritjen e ngrohtë e miqësore, duke theksuar se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i shkëlqyer në mes dy shteteve dhe forcave tona, të vazhdojnë edhe në të ardhmen me pasuesin e tij. Ndër të tjera, gjeneral Corell shprehu përshtypjet e larta të tij për nivelin e zhvillimit dhe avancimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si forcë profesionale dhe partnere dinjitoze e Gardës Kombëtare të Iowas.

Nënshkruhet memorandumi për trajnimin e mësimitdhënësve të matematikës në shkollat fillore të Prishtinës

PRISHTINË, 24 JANAR - Në Ditën Ndërkombëtare të Arsimit, kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit

me Fakultetin e Edukimit dhe TOKA për trajnimin e mësimitdhënësve të matematikës në shkollat fillore të Prishtinës. Kryetari Rama ka theksuar se përmes këtij trajnimi do

ta bëjnë lëndën e matematikës më të këndshme për fëmijët, duke integruar sa më shumë shembuj aplikativë për të pasur mësim sa më progresiv.



Moszbatimi i masave për kursim të rrymës, parashihen sanksione në Projektligjin e ri për Energjinë

PRISHTINË, 24 JANAR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka miratuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Energjinë. Para anëtarëve të Komisionit, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se përmes këtij projektligji do të zgjaten afatet për masat emergjente për krizën energjetike, ku vendimi parasheh që masat emergjente të jenë 90 ditë, me mundësi vazhdimi edhe për 90 ditë të tjera, ndryshe nga tash që janë vetëm nga 30 ditë.

Në anën tjetër, ajo ka theksuar se në masat për kursimin e energjisë në situatat emergjente do të përfshihet ndalimi i ndriçimit dekorativ, reklamues dhe kufizimi i ndriçimit publik. Për këto, përveç inspektoratit, ajo tha se do të angazhohet edhe Policia e Kosovës. “Janë dy çështje të rëndësishme në lidhje me masat emergjente të furnizimit me energjinë, afati i masave emergjente, si dhe masat për kursimin e energjisë dhe zbatimin e tyre. Projektligji parasheh masa të detyrueshme të kursimit të energjisë gjatë situatës emergjente dhe sanksione për moszbatimin e tyre. Masat e kursimit mund të caktohen me vendim të ministrit, ku përfshihet ndalimi i ndriçimit dekorativ, reklamues. Ndalimi



dhe kufizimi i ndriçimit publik, përveç ndriçimit të domosdoshëm për sigurinë e publikut dhe komunikacionit. Sanksionet për moszbatimin e masave përfshijnë gjobën, sekuestrimin e pajisjeve si dhe ndalimin e përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë”, ka thënë Rizvanolli.

Kundërshtime ndaj këtij projektligji ka shprehur kryetari i Komisionit, deputeti i PDK-së, Ferat Shala. Ai ka thënë se i njëjti nuk sjell ndonjë ndryshim të madh,

përveç komoditetit më të madh politik të Qeverisë së Kosovës. “Kam pritur se do të na sjellësh një ligj komplet të ri, konform rregullave, tregut, situatës dhe strategjisë së re që po pret të votohet në Kuvend. Këtu nuk shoh ndonjë ndryshim të madh, përveç që do t’i japë një komoditet vendimmarrjes politike, të tjerat do të mbesin në të njëjtën shkallë dhe dinamikë. Do të ishte mirë t’i shfrytëzoni këto kapacitete që të hartoni një ligj që do të kishte qenë

shumë më proaktiv dhe efikas në rrethanat që aktualisht jemi”, ka theksuar Shala. Shqetësime për këtë projektligj ka ngritur edhe deputeti i AAK-së, Pal Lekaj. Ai ka kërkuar që Policia e Kosovës mos të ketë angazhim shtesë në sanksionimin e moszbatimit të vendimeve për kursim të energjisë. “Ky është një projektligj i vonuar sepse ne kemi humbur shumë kohë sa iu përket vendimeve ad-hoc të Qeverisë, por edhe të Kuvendit që nuk kanë shkuar në favor të

qytetarëve të Kosovës, por që edhe i kanë shkaktuar dëme buxhetit të Kosovës. Si ligj keni pasur kohë shumë më herët që të procedoni dhe ne mos të merremi më tepër sa iu përket vendimeve”, ka thënë ai.

Duke iu kundërpërgjigjur, ministrja tha se Policia e Kosovës ka pasur rol në asistimin e sanksionimit edhe në kuadër të ligjeve të tjera. Ndërkohë, tha se gjatë agjendës legislative të këtij viti është paraparë edhe miratimi i ligjeve të tjera për energji. /KP/

Ministri i Bujqësisë: Dëmet nga vërshimet janë të konsiderueshme



MITROVICË, 24 JANAR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka vizituar komunën e Mitrovicës, Zubin Potokut, komunën e Skenderajt, të Klinës dhe komunën e Istogut për t’i parë nga afër dëmet e vërshimeve. Ai ka theksuar se dëmet nga vërshimet janë të konsiderueshme. “Në Mitrovicë e Zubin Potok vizitova bujqit e prekur nga këto vërshime dhe i inkurajova t’i dokumentojnë ato e t’i dorëzojnë pranë drejtorive për bujqësi. Po ashtu, përpos inspektimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore të bujqit, zhvillova takime me kryetarët, atë të komunës së Klinës, Zenun Elezaj, të komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe të komunës së Istogut, Ilir Ferati, të cilët më njoftuan për situatën sfiduese me të cilën po përballen komunitat. Bashkëndjeva me qytetarët e prekur nga

vërshimet, fatkeqësisht në Mitrovicë, Çabër, Skenderaj, Klinë dhe Istog, si dhe i sigurova ata se asnjë dëm nuk do të anashkalohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës”, ka shkruar Peci në “Facebook”.

Ai ka theksuar se nga ky vit Komisioni i Dëmeve në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës do t’i trajtojë të gjitha dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, përfshirë edhe dëmet në sektorin e bujqësisë.

Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm, vërshimet kanë prekur më së shumti komunën Skenderaj, Mitrovicë e Jugut, Klinë dhe Istog, duke dëmtuar ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturën rrugore.

Vërshimet kanë prekur edhe komunën Podujevë, Gjakovë dhe Pejë.

Pesë rregulla për një botë që plakët



Nga Ross DOUTHAT

Në botë ekzistojnë 2 lloje njerëzish: Ata që besojnë se sfida përcaktuese e shekullit XXI-të do të jetë ndryshimi i klimës, dhe ata që e dinë se do të jetë mungesa e lindjeve, rënia demografike, dhe plakja e botës. Gjatë 15 viteve të fundit, disa nga skenarët më të këqij në lidhje me ndryshimin e klimës janë bërë më pak të mundshme se më parë. Por në të njëjtën kohë, forca të ndryshme, sidomos pandemia e Covid-19, i kanë pakësuar më shpejt lindjet, duke e përshpejtuar epokën e plakjes së botës. Dëshmia më e fundit është lajmii javës së kaluar se popullsia në Kinë ra për herë të parë që nga Hopi i Madh përpara, mbi 60 vjet më parë. Parashikohej prej kohësh një moment rënieje, por deri vonë ajo nuk pritej të mbërrinte para viteve 2030. Megjithatë rënia ka mbërritur më herët, me lindshmërinë në Kinë që vitin e kaluar ka arritur nivelin më të ulët të regjistruar të të gjitha kohërave. Kjo do të thotë se tekta Kina që po shfaqet si gati një superfuqi, po shikon drejt një të ardhme të errët, ku do të plakët dhe ngecë në vend përpara se të pasurohet si vendet e Perëndimit.

Sfida të ngjashme kanë shumica e vende të pasura. Gjithsesi ia vlen të mendohet për disa rregulla mbi epokën e dekadencës demografike, tendencat që duhen parë, parimet që do të ndajnë fituesit dhe humbësit, që janë udhëzuese për cilindo që kërkon

dinamizëm në një botënë stanjacion.

Rregulli nr.1: Bota e pasur do të ketë nevojë për rishpërndarje nga të vjetrit tek të rinjtë

Dekadat e fundit ne kemi parë shumë raste të teknokratëve që kanë gabuar në supozimet e tyre. Nga besimi i përhapur se thujse menjëherë pas krizës financiare kishim nevojë për një reduktim të deficitit, tek optimizmi i pamatur për efektet e tregtisë së lirë me Kinën.

Por në një botë të plakur, dëshira teknokratike për të reformuar të drejtat e të moshuarve do të bëhet gjithnjë e më thelbësore dhe korrekte, për sa kohë që kursimet mund të përdoren për ta bërë më të lehtë për të rinjtë që të krijojnë një familje, të hapin një biznes dhe të kenë një shtëpi. Dhe vendet që gjejnë një mënyrë për ta bërë këtë transferim me sukses, do të jenë shumë përpara atyre që sapo do të zhyten në një gerontokraci (sundim nga të moshuarit).

Rregulli nr.2: Inovacioni nuk mjafton; sfida do të jetë zbatimi dhe adoptimi i saj

Nëse dëshironi rritje ekonomike në një botë të plakur, atëherë do të keni nevojë për përparime teknologjike. Por siç vuri në dukje ekonomisti Eli Dourado në një artikull të kohëve të fundit në lidhje me efektet e

teknologjisë së re të Inteligjencës Artificiale, pengesat e mëdha nuk janë gjithmonë tek vetë shpikja.

Ato vërehen në testim, infrastrukturë, vendosje dhe tek kufizimet rregullatore. Dhe meqenëse shoqëritë e plakura, të vendosura në mënyrat e tyre, mund të jenë më të prirura për të lënë mënjane shpikjet, pastrimi i këtyre pengesave mund të bëhet sfida kryesore e novatorit.

Rregulli nr.3: Lufta tokësore do të jetë kundër kufijve të popullsisë

Ju mund ta shihni tashmë këtë dinamikë në luftën Rusi-Ukrainë. Përpjekjet për mobilizimin e rekrutëve të rinj nga Vladimir Putinit, nuk janë ato që me sa duket do të ishin, nëse perandoria e tij do të kishte më shumë të rinj. Ukraina, me nivele edhe më të ulëta të lindjeve edhe se Rusia, përballet me një thellim të krizës demografike, në rast se lufta do të zgjasë me vite. E njëjta gjë vlen për Tajvanin dhe vatrat e tjera të nxehta: edhe aty ku ambicet strategjike kërcënojnë me një luftë të afërt, dhimbja e çdo viktimë do të komplikohet në mënyrë dramatike.

Rregulli nr.4: Në "mbretërinë" e të moshuarve, do të vlejë pak rini dhe vitalitet shtesë

Kjo është e vërtetë në nivel

global: Vendet që arrijnë të mbajnë ose rrisin nivelet e tyre të lindjeve afër nivelit të zëvendësimit, do të kenë një avantazh afatgjatë ndaj vendeve që zhyten në një krizë të lindshmërisë si Koreja e Jugut dhe nivelit të gjysmë-zëvendësimit.

Dhe kjo do të jetë e vërtetë edhe brenda shoqërive. Për të parashikuar shtetet dhe qytetet më dinamike amerikane, traditat dhe ideologjitë fetare më me ndikim, duhet të kërkonin vende dhe grupe që janë më miqësore jo vetëm për të rinjtë, por edhe për të rinjtë që kanë vetë fëmijë.

Rregulli nr.5: Diaspora afrikane do të riformësojë botën

Sa më shpejt që të ndodhë plakja në botën e pasur dhe me të ardhura mesatare, aq më i rëndësishëm është fakti që popullsia e Afrikës është ende në rrugën e duhur për të arritur në 2.5 miliardë në vitin 2050, dhe për të arritur 4 miliardë deri në vitin 2100. Lëvizja edhe e një pjese të kësaj popullsie, do të jetë ndoshta transformimi global më domethënës i shekullit XXI-të. Dhe ekuilibri midis asimilimit të suksesshëm nga njëra anë, dhe destabilizimit dhe reagimit nga ana tjetër, do të ndihmojë në përcaktimin nëse epoka e rënies demografike do të përfundojë në një rigjallërim apo në një kolaps. / "New York Times" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kupa në Rahovec

PRISHTINË, 24 JANAR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur të hënën në Prishtinë ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin e Kosovës. Me këtë rast FBK-ja e ka miratuar raportin e punës të FBK-së për vitin 2022, planin e veprimit për vitin 2023, planin e marketingut dhe komunikimit 2023, planin financiar për vitin 2023. Në këtë mbledhje është vendosur që kuvendi i punës i FBK-së të mbahet më 22 mars në Prishtinë, kurse janë miratuar propozicionet e garave të Kupës

së Kosovës 2022/23 dhe është vendosur që Kupa të mbahet në Rahovec nga 15 deri më 19 shkurt. "Final 8" Kupa e Kosovës të organizohet në palestrën 'Mizahir Isma' prej 15 deri më 19 shkurt nga KB Rahoveci me këto kushte: Do të lejohen shikuesit në palestër, por vetëm në mënyrë jo të organizuar, si dhe pa simbole dalluese, biletat duhet të blihen vetëm me letërnjoftime, kërkesë për prokuror kujdestar për të qenë në palestër në datat e organizimit të eventit, si dhe vënia në funksion e kamerave në palestër, si dhe masa të larta të

sigurisë, duke përfshirë këtu Policinë e Republikës së Kosovës dhe sigurimin privat", thuhet në njoftimin e FBK-së. Federata e Basketbollit e ka miratuar propozimin për ristrukturim të zyrës ekzekutive të FBK-së (ndarja në departamente) dhe janë miratuar ndryshimet në rregulloren për organizim të brendshëm të FBK-së. janë emëruar përzgjedhësit e përfaqësuesve të reja të Kosovës, ndërsa shpallja e laureatëve në basketboll për vitin 2023 të bëhet në muajin dhjetor.



16 gjyqtarë pajisen me stemën e FIFA-s, Kosova bëhet edhe me treshe të gjyqtareve

PRISHTINË, 24 JANAR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, së bashku me kryetarin e Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, kanë pritur të martën 16 gjyqtarët të cilët janë licencuar për garat ndërkombëtare dhe me këtë rast edhe u janë dorëzuar stemat e FIFA-s. Vit pas viti numri i gjyqtarëve kosovarë me stemë të FIFA-s është rritur, derisa për herë të parë Kosova është bërë edhe me treshe të gjyqtareve, pasi tashmë krahas, Lumturije Muhadrit, janë licencuar edhe Rita Vehapi, si gjyqtare kryesore dhe Fitore Govori si asistente.



Kryetari Ademi përgëzoi të rikonfirmuarit me stemë të FIFA-s, derisa gjyqtareve që u pajisen për herë të parë me këtë stemë u shprehu urimet më të mira, me

shpresë se do të kenë rrugëtim të suksesshëm në garat evropiane. Numri një i FFK-së vlerësoi punën e gjyqtarëve si në kampionatin vendor ashtu edhe

KJO ËSHTË LISTA E GJYQTARËVE QË KANË MARRË STEMËN E FIFA-S:

Gjyqtarë kryesorë	4. Fatmir Sekiraqa
1. Genc Nuza	5. Edmond Zeqiri
2. Visar Kastrati	6. Besnik Morina
3. Mervan Bejtullahu	7. Granit Hyseni
4. Rita Vehapi	8. Arbnor Bullatovci
	9. Fitore Govori
Asistentë	Gjyqtarët e futbollit
1. Fatlum Berisha	1. Besar Beqiri
2. Bujar Selimaj	2. Besart Ismajli
3. Lumturije Muhadri	3. Florentina Kallaba

në arenën ndërkombëtare, derisa kërkoi nga ata ta vazhdojnë punën e tyre me përkushtim drejt progresit të mëtijshëm. Ai u shpreh i lumtur që tashmë Kosova është bërë edhe me treshe të gjyqtareve për futbollin e vajzave/grave, gjë e cila, siç theksoi ai, dëshmon punën e mirë që vitet e fundit është bërë

edhe në këtë segment. Ndërkaq, në emër të kolegëve të tij, Genc Nuza falënderoi kreun e FFK-së për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë sektorit të gjyqtarëve, veçmas për instalimin e sistemit VAR në futbollin vendor dhe për mundësitë e ofruara për të qenë në hap me kohën dhe zhvillimet në futbollin evropian.

Khaka: Para tre vjetësh e preka fundin, tash jam lider dhe në majë



CYRIH, 24 JANAR - Granit Xhaka është zgjedhur futbollisti i vitit në Zvicër. Mesfushori me prejardhje nga Kosova e kurorëzoi kështu një vit fantastik të cilin e kaloi. Ai ndihet i lumtur për këtë vlerësim, ndërsa i falënderoi të gjithë atë që e ndihmuan të arrinte deri këtu. Granit Xhaka është zgjedhur futbollisti më i mirë i vitit 2022 në Zvicër.

Mesfushori u nderua në "Natën e Futbollit të Zvicër", që u mbajt në Casino Bern. 30-vjeçari u shpërblye kështu nga Federata Zvicerane e Futbollit dhe nga Liga Zvicerane e futbollit për vitin fantastik që e kaloi. Përfaqësuesi zviceran në këtë garë i mposhti shokët e skuadrës, Yann Sommer dhe Manuel Akanji. Futbollisti i Arsenalit u shpreh i lumtur që u

zgjodh më i miri i vitit. Në vitin që shkoi, ai shkëlqeu me Arsenalin dhe me Kombëtaren e Zvicrës në Botërorin e Katarit. "Jam mjaft krenar për këtë çmim. Ju falënderoj të gjithëve. E falënderoj trajnerin, familjen dhe të gjithë ata që besuan tek unë. Tri vjet më parë e preka fundin në Arsenal dhe tash jam atje si lider dhe në majë të tabelës. Çmimi do

të thotë shumë për mua", ka thënë kapiteni i "Helvetikëve". Ai synon ta fitojë titullin e kampionit me Arsenalin dhe ta kurorëzojë kështu një sezon fantastik që po e kalon me "Topçinjtë". Xhaka u shpall futbollisti i vitit në Zvicër për herë të dytë. Herën e parë këtë ndjenjë e kishte përjetuar në vitin 2017.

Krasniqi më 25 shkurt përballet me boksierin më të mirë të Belgjikës

PRISHTINË, 24 JANAR - Boksieri shqiptar Robin Krasniqi do të rikthehet në ring më 25 shkurt. Krasniqi ka bërë me dije kundërshtarin, i cili do të jetë numri një i Belgjikës, Timur Nikarkoev. "Jam shumë i lumtur t'ju informoj, se me datë 25 shkurt 2023 do të

rikthehem në ring në arenën madhështore 'Audi Dome' të qytetit gjerman Munchen. Kundërshtari im do të jetë numri një i Belgjikës, Timur Nikarkoev. Së bashku me mua në atë mbrëmje do të boksojnë edhe shumë boksierë shqiptarë (siç janë: James Kraft,

Shefat Isufi, Armend Xhoxhaj, Isuf Kelmendi dhe Kushtrim Tahirukaj)", ka shkruar Krasniqi. Ai ka potencuar se mezi pret për ta shënuar fitoren, teksa përmend padrejtësinë që i është bërë, sipas tij, në duelin e fundit kundër gjermanit Dominic

Boesel. "Me padurim po e pres këtë mbrëmje, për ta shënuar fitoren e radhës dhe për t'ju gëzuar të gjithëve, sepse mbështetja që më keni dhënë ju miqtë dhe tifozët e mi të dashur, pas padrejtësisë që më është bërë në duelin tim të fundit, ka qenë e papërshkueshme".



Pritje madhështore për vashat e Kosovës që bënë historinë

PRISHTINË, 24 JANAR - Përfaqësuesja U17 e Kosovës në volejboll është pritur në mënyrë madhështore në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë.

Presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi dhe anëtarët e bordit, Halime Fetahu, Abedin Mehani e Valon Xhafaj, i kanë përgëzuar

vashat për arritjet dhe përfaqësimin e Kosovës në formën më të mirë. Buqeta me lule dhe ëmbëlsira ishin të rezervuara për vajzat, nga prindërit dhe familjarët e tjerë, që ishin

të pranishëm në numër të madh në aeroport. Kosova U17 e siguroi për herë të parë kalimin për raundin e dytë të kualifikimeve për CEV Kampionatin Evropian, pasi doli e pesta



nga kualifikimet e fazës së parë.

Hamiltoni: Më kanë bullizuar pasi isha me ngjyrë, më gjuanin me banane

LONDËR, 24 JANAR - Piloti britanik Lewis Hamilton, shtatë herë kampion bote në Formula 1, ka rrëfyer të shkuarën e tij dhe periudhën kur ishte ende një fëmijë dhe i panjohur. Ai ka deklaruar se racizmi ndaj tij ka qenë i fortë: "Kam qenë viktimë e bullizmit kur isha gjashtë vjeç. Asokohe isha në shkollë dhe isha një nga nxënësit e paktë me ngjyrë. Më të rriturit, më të fortë dhe abuzues, më tallnin shumicën e kohës". Piloti i Mercedesit shprehet se talljet nuk ishin fyerjet e vetme ndaj tij, pasi dhuna psikologjike ishte e madhe. "Kur mësoja historinë nuk shihja asnjë foto të njerëzve me ngjyrë dhe pyet veten përse. Mësuesit më thoshin nuk do të bëhesha dikushi në jetë. Kujtoj që qaja në oborrin pas shkollës dhe i thosha vetes që nuk do të bëhesha ndonjëherë dikushi", kujton Hamiltoni.

Gjithsesi, Lewis Hamiltoni është piloti me më shumë fitore në Formula 1, njeriu që mban



shumë rekorde. Një njeri që e nisi rrugëtimin e jetës së tij në rrugicat në periferi të Londrës për të qenë në majën e Formulës 1. "Sistemi ka qenë kundër meje, Formulës 1 dhe isha kundër rrymës. E shkuara ime më kë bëre ky që jam sot. Dikur nuk flisja në shtëpinë time për këto gjëra, pasi nuk doja që babai im të mendonte se nuk isha i fortë", tha Hamiltoni.

Vjet, një legjendë e Formulës 1, Nelson Piquet, e quajti "zezaku i

vogël", duke konfirmuar abuzimet ndaj tij. "Ka ende një mentalitet të keq që duhet ndryshuar, njerëz që nuk duhet të kenë vend në sportin tonë. Këto sjellje më kanë rrethuar gjithë jetën. Madje më kanë hedhur edhe banane. Kur më shanin në gara, babai im më thoshte gjithnjë të isha i qetë dhe t'ia lija gjithçka pistës dhe aty tregova se kush jam", ka deklaruar Hamiltoni.

Milwaukee rikthehet ekip i frikshëm, humbasin Bostoni e Memphis

DETROIT, 24 JANAR - Milwaukee rikthehet një skuadër e frikshme pas fitores me rezultat 150-130 ndaj Detroitit jashtë fushës. Antetokounmpo realizoi 29 pikë e 12 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Bogdanoviqit për vendasit. Pa probleme fiton edhe Utah Jazzi që, falë 25 pikëve e 11 reboundeve të Markkanenit, mundi me rezultat 120-102 Charlotten. Zhgënjën Bostoni, që u mund me rezultat 113-98 nga Orlando, por kjo humbje nuk e prek kreun e skuadrës së Celticsit. Banhero



me 23 pikë ishte shënuesi më i mirë për Orlandon. Fitore me vlera arriti skuadra e Houstonit, që mundi me rezultat 119-114 Minnesotan. Jalen Green realizoi 42 pikë për skuadrën teksane. Humbja e tretë radhazi për Memphisin, por që ruan vendin e

dytë në Perëndim. Skuadra e Memphisit u mund me rezultat 133-100 nga Sacramento, sfidë ku diferencën e bëri Lyles me 24 pikë. Fiton edhe Chicago, 111-100 ndaj Atlantës, me DeRozan protagonist, autor i 26 pikëve për Bulls-in.

REZULTATET

DETROIT - MILWAUKEE	130-150
ORLANDO - BOSTON	113-98
CHICAGO - ATLANTA	111-100
HOUSTON - MINNESOTA	119-114
UTAH JAZZ - CHARLOTTE	120-102
PORTLAND - SAN ANTONIO	147-127
SACRAMENTO - MEMPHIS	133-100

Messit i rritet oreksi, vë në siklet PSG-në

Në Paris besojnë se Leo Messi do ta rinovojë kontratën e tij e cila përfundon në fund të këtij sezoni. Sipas medieve franceze, kampioni i botës do të takohet me presidentin Al-Khelaifi për të negociuar mbi mundësinë e

zgatjes së bashkëpunimit. Në fakt, përpara fillimit të Botërorit palët kishin një akord në parim për ta rinovuar kontratën, të paktën deri më 2024, por gjërat me sa duket kanë ndryshuar pasi Messi fitoi Botërorin, trofeun që

aq shumë dëshironte. Nga Spanja gazetari i njohur Gerard Romero, i cili njihet për marrëdhënien e tij të afërt me klubin e Barcelonës, shkruan se "pleshti" ka vendosur që në fund të sezonit të largohet nga Parisi.

Kjo për drejtuesit e PSG-së është thjesht një lajm dashakeqës që synon të sjellë pështjellim. Fakt është që Messi kërkon një trajtim ndryshe tani që u shpall kampion bote, 30 milionë euro në sezon është një shifër që nuk e

bind plotësisht. Për momentin në tavolinën e Jorge Messit, babai dhe agjenti i Leos, janë dy oferta, njëra nga Inter Miami i Beckhamit dhe tjera nga Arabia Saudite, ku Al-Hilal i ofron 300 milionë euro në sezon.

SHKURT

Krasniqi i mjafton një ndeshje, futet në formacionin e javës në Rumani

Ermal Krasniqi debutoi te Cluj në fitoren 3-0 ndaj Farul Constantas në kuadër të javës së 22-të në Superligën e Rumanisë. Ishte një debutim ëndrrash për malishevasin, që ia doli ta realizonte golin e parë të takimit në minutën e 49. Krasniqi asistoi për golin e tretë të realizuar nga Claudiu Petrilă në minutën e 77. Me këtë fitore, të arritur falë Ermalit, Cluji ia doli të bëhej lider i ligës me 47 pikë, me Farul që është në vendin e dytë me dy më pak. Paraqitja e tij nuk ka kaluar pa u vënë re edhe nga federata e futbollit rumun, që e ka vendosur atë në formacionin e javës.

Torino nxjerr në shitje Berishën

E ardhmja e portierit të Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, mbetet ende një mister, por sa vijë edhe ulen shanset që ai të qëndrojë në Torino. Shtatlarti nga Kosova duket është nxjerrë në merkato nga klubi i Serisë A. Shenjat e para erdhën që në fund të vitit që lamë pas, teksa një deklaratë e portierit ku thoshte se kërkonte minuta ose do të shikonte një mundësi tjetër, trazuan disi ujërat. 33-vjeçari nuk ka luajtur në asnjë ndeshje zyrtare këtë sezon me Torinon, teksa është preferuar nga Juriç vetëm në disa miqësore. Tashmë me ngjarjet e fundit duket se ndarja është e pashmangshme. Sipas medieve italiane, portieri është nxjerrë në merkato dhe për këtë arsye nuk ishte i grumbulluar në ekip gjatë ndeshjes së fituar 0-1 që piemontezët arritën ndaj Fiorentinës. Në medie kanë dalë disa alternativa për numrin një të Shqipërisë, teksa interes ka treguar edhe Reggina me trajner Filippo Inzaghin, ekip që pretendon të ngjitet në Serinë A.

Bale nis karrierën në golf

Gareth Bale njoftoi para pak ditëve tërheqjen nga futbolli i luajtur teksa e mbylli aventurën në Amerikë ku për herë të fundit veshi fanellën e Los Angeles. Uellsiani vendosi t'i "varë këpucët në gozhdë" në moshën 33-vjeçare edhe pse ofertat nga klube të njohura nuk i munguan. Dëshira e Bales për të ushtruar lirisht një tjetër sport si golfi mbizotëroi me ish-sulmuesin që tashmë ka vendosur t'i përkushtohet me kohë të plotë zanatit të ri. Së fundmi, Bale do të marrë pjesë në një turne të golfit që zhvillohet në muajin shkurt në California, teksa fituesi i këtij kompeticioni do të përfitojë një shifër prej 9 milionë paundësh. Ndërkaq, në këtë turne pritet të marrin pjesë 156 lojtarë profesionistë të golfit me Bale që do të garojë kundër tyre për të treguar nëse mund të jetë i suksesshëm edhe në këtë sport.

Santosi emërohet trajner i Polonisë

Fernando Santos është trajneri i ri i kombëtares së Polonisë. Emërimi i tij u bë i ditur nga kreu i federatës polake të futbollit. Santos është ish-trajneri i Portugalisë. Trajneri 68-vjeçar luzitan do të drejtojë një ekip në krye të skuadrës së Robert Lewandowskit. Santos është trajneri i tretë i Polonisë i cili ka lindur jashtë vendit, pasi me herët ishin edhe holandezi Leo Beenhakker dhe portugezi Paulo Sousa. Detyra e tij është ta përmirësojë rekordin zhgënjyes të Polonisë në turnetë e fundit të mëdhenj. Polonia nuk e rinovoi kontratën e trajnerit Michniewicz pasi arriti në fazën eliminatorë të Kupës së Botës për herë të parë në 36 vjet.



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.294 të datës 25.01.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Mekanik
Numri i pozitave: 4 (katër)
Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi
Periudha provuese: 3 muaj
Niveli i Pagës: XV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim profesional nga fusha e mekanikës
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;>
- Dëshmi mbi shkollimi
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com.
 Konkursi është i hapur nga data 25.01.2023 dhe përfundon më datë 08.02.2023 deri në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2023

1

NPK "Trafiku Urban" SHA
 Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
 web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.292 të datës 25.01.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Riparues Karroserie dhe Autongjyrosës
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi
Periudha provuese: 3 muaj
Niveli i Pagës: XV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim profesional nga fusha e auto-ngjyrosjes apo të ngjashme;
- 1 vit përvojë pune në fushën përkatëse;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;>
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com,
 Konkursi është i hapur nga data 25.01.2023 dhe përfundon më datë 08.02.2023 deri në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2023

1

NPK "Trafiku Urban" SHA
 Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
 web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.298 të datës 25.01.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi
Periudha provuese: 3 muaj
Niveli i Pagës: XXI

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i mesëm, licencë për sigurim fizik
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;>
- Dëshmi mbi shkollimi
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com.
 Konkursi është i hapur nga data 25.01.2023 dhe përfundon më datë 08.02.2023 në ora 16:00.
Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
 25.01.2023

1

NPK "Trafiku Urban" SHA
 Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
 web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.296 të datës 25.01.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Depoist Ndërrimi
Numri i pozitave: 1 (një)
Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi
Periudha provuese: 3 muaj
Niveli i Pagës: XV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i mesëm nga fusha e teknikës, ekonomisë apo logjistikës;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;>
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com,
 Konkursi është i hapur nga data 25.01.2023 dhe përfundon më datë 08.02.2023 deri në ora 16:00.
Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2023

1

NPK "Trafiku Urban" SHA
 Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
 web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.297 të datës 25.01.2023, UD Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" S.H.A, Prishtinë, shpall:

KONKURSI JASHTËM

Pozita e Punës: Kontrollor Komunikacioni

Numri i pozitave: 2 (dy)

Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i Mesëm;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com, Konkursi është i hapur nga data 25.01.2023 dhe përfundon më datë 08.02.2023 deri në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

1



